



Në bazë të nenit 35, paragrafit 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit nr. 03 / L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77/16 gusht 2010), nenit 1, nenit 44 paragrafi 1, nënparagrafi 1.6 dhe nenit 85 të Ligjit nr. 04 / L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/11 Maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 30 prill 2015, miratoi si vijon:

RREGULLORE PËR KASAFORTËN

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj Rregullore është që të definojë rregullat, procedurat dhe kushtet për hapjen e kasafortës si dhe ruajtjen e sendeve në kasafortë.
2. Kjo Rregullore aplikohet për të gjitha bankat e licencuara nga Banka Qendrore për të operuar në Kosovë, të cilat do të ofrojnë shërbimin e ruajtjes së letrave me vlerë dhe sendeve tjera të çmueshme përmes sigurimit të kasafortave brenda objekteve të tyre për klientët e tyre (në vijim: *banka*).

Neni 2

Përkufizimet

1. Të gjithë termat e përdorura në këtë Rregullore kanë kuptim të njëjtë me termet e përkufizuara në nenin 3 të Ligjit nr.04/L-093 për banka, institucione mikrofinanciare dhe institucione financiare jobankare (në vijim: Ligji për bankat) dhe / ose me përkufizimet në vijim për qëllimin e kësaj Rregulloreje:
 - 1.1. **“Kasaforta”** nënkupton një kuti të mbyllur që gjendet në bankë dhe që shfrytëzohet nga shfrytëzuesi për të mbajtur sendet e vlefshme, letrat me vlerë, dokumentet dhe sendet e tjera që janë të lejuara me ligj që të mbahen në kasafortë;
 - 1.2. **“Shfrytëzues”** nënkupton çdo person fizik apo juridik i cili hap dhe shfrytëzon një kasafortë sipas kushteve të kontraktuara;
 - 1.3. **“Fuqia Madhore”** nënkupton rastet apo rrethanat, apo kombinimin e rasteve e rrethanave (përfshirë edhe efektet e tyre) të cilat janë jashtë kontrollit të një pale, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në: zjarr, vërshim, vetëtimë, stuhi, tornado, tërmet, rrëshqitje e tokës, sëmundje epidemike, luftë, luftë civile, veprat e armiqve, si dhe/ose grevë, mbyllje përbrenda apo trazira të tjera industriale.

Neni 3

Kontrata për Kasafortën

1. Me kontratën mbi kasafortën banka obligohet t'i ofrojë në dispozicion shfrytëzuesit kasafortën për një periudhë të caktuar kohe, ndërsa shfrytëzuesi obligohet që për këtë shërbim t'i paguajë bankës një provizion të caktuar.
2. Banka duhet të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme, që janë nën kontrollin dhe kompetencat e bankës për të siguruar gjendje të mirë dhe mbikëqyrje të duhur të kasafortës.
3. Banka nuk është përgjegjëse në rast se vlera e sendeve, që ruhen në kasafortë zvogëlohet ose objektet shkatërrohen, si dhe në rast se dëmi ndodh për shkak të këtyre rrethanave:
 - 1.1. Dëmi shkaktohet nga shfrytëzuesi ose nga personi shoqëruar i tij;
 - 1.2. Dëmi shkaktohet nga fuqia madhore;
 - 1.3. Dëmi shkaktohet nga natyra e sendit;
 - 1.4. Dëmi shkaktohet nga kushtet që nuk mund të ndikohen nga banka;
4. Tarifa dhe metoda e pagesës përcaktohet nga kontrata për kasafortën e nënshkruar nga shfrytëzuesi dhe banka.
5. Shfrytëzuesi i kasafortës mund të sigurojë përmbajtjen e kasafortës, sipas policave të sigurimit në dispozicion, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm në Republikën e Kosovës.
6. Banka nuk merr asnjë përgjegjësi apo obligim për sigurimin e përmbajtjes së kasafortës.

Neni 4

Hapja e Kasafortës

1. Hapja e kasafortës mund t'i lejohet vetëm shfrytëzuesit ose të autorizuarit të tij përmes një autorizimi të noterizuar ose ndonjë vërtetimi të barasvlershëm nëse autorizimi është nga një shtet jashtë Kosovës.
2. Në rast se shfrytëzuesi i kasafortës është person juridik, hapja e një kasaforte mund t'i lejohet vetëm personit, i cili ka nënshkruar marrëveshjen për kasafortën si përfaqësues i personit juridik ose një person i autorizuar nga ky i fundit përmes një autorizimi të noterizuar.
3. Kur shfrytëzuesi ia jep çelësin e kasafortës një personi të autorizuar ai mban përgjegjësinë e plotë për secilin dëm material që ndodh nga autorizimi i dhënë.
4. Banka nuk lejohet që të mbajë çelësin e kasafortës së shfrytëzuesit.
5. Kasaforta mund të hapet vetëm me një urdhër të gjykatës edhe kur kërkesa për hapje bëhet nga autoriteti përkatës.
6. Kur kasaforta hapet me urdhër të gjykatës, të paktën dy persona (një përfaqësues i gjykatës dhe një përfaqësues i bankës) duhet që gjithmonë të jenë prezent gjatë procedurës së hapjes së kasafortës.

7. Kur kasaforta hapet me urdhër të gjykatës, çfarëdo shpenzimesh lidhur me hapje apo dëmtimin eventual të kasafortës gjatë hapjes, në rast të hapjes me forcë, përfundimisht do të bien në barrën e shfrytëzuesit të kasafortës.
8. Kur kasaforta hapet me kërkesë nga autoriteti përkatës dhe për të cilën ka urdhër nga Gjykata, shpenzimet e hapjes apo dëmtimit të kasafortës gjatë hapjes, në rast të hapjes me forcë, përfundimisht do të barten nga autoriteti publik që e lëshon urdhër kontrollin.
9. Hapja e kasafortës me urdhër të gjykatës apo me kërkesë të autoritetit përkatës i cili posedon urdhrin nga Gjykata për hapje të kasafortës, do të bëhet me njoftimin paraprak të bankës prej së paku 24 orë dhe ekzekutimi i hapjes do të bëhet jashtë orëve të punës së bankës.

Neni 5

Kufizimet për vendosjen e sendeve në Kasafortë

1. Shfrytëzuesi nuk lejohet të vendosë në kasafortën e vet sendin ose produktin, që mund të vë në rrezik sigurinë e bankës apo të kasafortave të tjera, duke përfshirë lëndë eksplozive, lëndë intoksikuese apo të ngjashme.
2. Shfrytëzuesi nuk lejohet të vendosë në kasafortën e vet sendin ose produktin që mund të kundërmojë apo materie organike, gjallesa dhe materie të rrezikshme.
3. Në rastin kur shfrytëzuesi nuk i përmbahet detyrimit të specifikuar në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, Banka mund të ndërpresë njëanshëm kontratën mbi kasafortën.

Neni 6

Qasja në Kasafortë

1. Banka mund të shfrytëzojë sistemin për identifikimin e shfrytëzuesit të kasafortës me kartën e tij/saj të qasjes, identifikuesit biometrik, shenjat e gishtërinjve të tij/saj apo çfarëdo mënyre tjetër të sigurisë të ngjashme, që mund të përdoret për identifikimin e shfrytëzuesit të kasafortës.
2. Banka është e autorizuar që të kontrollojë qasjen në kasafortë dhe të regjistrojë të gjithë personat, që i qasen asaj, që mund të jenë përveç shfrytëzuesit të kasafortës edhe personat e autorizuar nga shfrytëzuesit e kasafortës.

Neni 7

Të drejtat e bankës në rast mospagimi

1. Në qoftë se shfrytëzuesi nuk i paguan bankës të paktën një këst të provizionit për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e kasafortës në kohën e përcaktuar për pagesë, banka mund ta ndërpresë kontratën njëanshëm pasi të kenë kaluar tridhjetë (30) ditë nga data, kur banka e ka paralajmëruar shfrytëzuesin me shkrim për obligim të pagesës.
2. Pasi të ndërpresë kontratën, banka mund ta ftojë shfrytëzuesin, që të bëjë zbrazjen e kasafortës dhe t'ia dorëzojë çelësin, e nëse shfrytëzuesi nuk e bën këtë, banka mund të

kërkojë që kasaforta të hapet me urdhër gjykate, të konstatohet përmbajtja e saj dhe sendet e gjetura të vihen në depozitë të gjykatës ose t'i besohen bankës për ruajtje.

3. Derisa të merret urdhri i gjykatës dhe të bëhet ekzekutimi i të njëjtit, shfrytëzuesit të kasafortës do t'i ngarkohet detyrimi për pagesë sipas kështit të rregullt të provizionit për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e kasafortës që rrjedh për pagesë, pasi që të njëjtën kasafortë banka nuk mund ta shfrytëzojnë pa u zbratur. Të gjitha shpenzimet, në këtë rast do të barten nga shfrytëzuesi.
4. Të gjitha shpenzimet dhe kostot e bartura nga banka për hapjen e kasafortës me urdhër të gjykatës duhet të konsiderohen si pjesë e debituar për kompensim dhe të paguhen nga shfrytëzuesi, ose duke debituar llogarinë bankare të tij/saj ose nga paratë e gatshme, që gjenden në kasafortë apo nga shitja e gjërave tjera të çmueshme të cilat gjenden në kasafortë. Në rast të ndonjë shpenzimi apo kostoje të shoqëruar me hapjen apo dëmtimin e mundshëm të kasafortës gjatë hapjes, në ato raste kur bëhet hapja me forcë, të gjitha ato duhet të paguhen nga ana e shfrytëzuesit të kasafortës.
5. Të gjitha njoftimet/ftesat banka do t'ia dërgojë shfrytëzuesit me shkrim përmes një poste të certifikuar në adresën e tij/saj të specifikuar në kontratën për kasafortë, përveç nëse banka është njoftuar nga shfrytëzuesi për ndërrimin e adresës.

Neni 8

Arkëtimi i provizioneve të bankës

1. Në rast se shfrytëzuesi nuk i përgjigjet njoftimit të bankës për vonesë të pagesave dhe kasaforta hapet me urdhër të gjykatës, banka ka të drejtë të mbledhë provizionet e papaguara dhe shpenzimet e tjera, që rrjedhin nga kontrata për kasafortë, si dhe shpenzimet gjyqësore dhe shpenzimet e tjera, që mund të dalin gjatë procedurës nga të hollat e gatshme, që gjenden në kasafortë dhe nga vlera e arritur nga shitja e sendeve të vlefshme që gjenden në kasafortë.
2. Banka ka të drejtë që të shesë sendet e vlefshme, që gjenden në kasafortë në rastet kur nuk ka ndonjë mënyrë tjetër për arkëtimin e provizioneve të bankës përmes të hollave të gatshme, që gjenden në kasafortë ose përmes parave në xhironlogarinë bankare të shfrytëzuesit. Kjo çështje duhet të jetë pjesë e kontratës.
3. Banka mund të shesë sendet e vlefshme që gjenden në kasafortë përmes ankandit publik sipas procedurave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi për ankandet publike.
4. Nëse asnjë send i vlefshëm nuk gjendet në kasafortë, që do të mund të shiteshin dhe që të mbulohej provizioni i bankës ose nëse shfrytëzuesi nuk ka fonde të disponueshme në llogaritë e depozitave, banka mund të arkëtojë provizionet e saj dhe shpenzimet pasuese përmes procedurës gjyqësore.
5. Pasi që është hapur kasaforta me urdhër të gjykatës dhe pasi që banka ka arkëtuar provizionet e saj, sendet e mbetura të kasafortës do të lihen në depozitë të gjykatës. Pas dorëzimit të gjësendeve në gjykatë, banka nuk do të mbajë asnjë lloj përgjegjësie në

raport me sendet e dorëzuara, me përjashtim që do të duhet t'i ruan dokumentet për ta dokumentuar se çka është shitur, inkasuar dhe çka është dorëzuar në gjykatë.

Neni 9 **Ndërprerja e Kontratës**

1. Kontrata mund të ndërpritet në mënyrë te njëanshme nga njëra palë, ose me pajtimin e të dy palëve kontraktuese.
2. Banka mund të pranojë ndërprerjen e kontratës, me kusht që shfrytëzuesi ka shlyer në mënyrë të rregullt obligimet e tij/saj, ka kthyer të gjitha kopjet e çelësave, kartat e qasjes (nëse ka) dhe çfarëdo veçorie të sigurisë që i është dhënë në dispozicion nga banka për të kryer qasjen, nëse kasaforta është zbrazur dhe nuk i është shkaktuar ndonjë dëm.
3. Banka mund të ndërprejë kontratën në rast se shfrytëzuesi nuk i përmbahet kontratës dhe në rast se shfrytëzuesi, nuk paguan tarifën për shfrytëzimin e kasafortës brenda 30 ditëve nga dita kur njoftimi me shkrim për pagesën e tarifës, së dërguar nga banka te shfrytëzuesi është dorëzuar.

Neni 10 **Vdekja e shfrytëzuesit**

1. Kontrata do të ndërpritet prej momentit, që banka informohet se shfrytëzuesi ka vdekur. Menjëherë pas njoftimit të vdekjes së shfrytëzuesit, banka do të bllokojë kasafortën dhe do të lejojë qasjen vetëm duke u bazuar në një aktgjykim të plotfuqishëm të trashëgimisë të lëshuar nga gjykata përkatëse apo me aktvendim të trashëgimisë, të lëshuar nga autoriteti publik kompetent.
2. Në rastet kur vdes shfrytëzuesi dhe për një periudhë prej një (1) viti nga dita kur banka ka kuptuar për vdekjen e shfrytëzuesit nuk lajmërohet ndonjë trashëgimtar apo person tjetër, që dëshmon interesin atëherë banka do të kërkojë, që kasaforta të hapet me urdhër të gjykatës, që të konstatohet përmbajtja e saj dhe sendet e gjetura të vihen në depozitë të gjykatës ose t'i besohen bankës për ruajtje.
3. Banka nuk merr asnjë përgjegjësi në raste kur shfrytëzuesi i kasafortës vdes dhe banka nuk ka qenë e njoftuar për vdekjen e tij/saj, derisa personat e autorizuar i qasen dhe marrin në posedim përmbajtjen e kasafortës.
4. Sapo të njoftohet banka për vdekjen e shfrytëzuesit, banka do të njoftojë gjykatën dhe/apo noterin përkatës për ekzistencën e kasafortës.
5. Në rastin kur pasardhësi/pasardhësja ligjore apo trashëgimtari/trashëgimtarja nuk ka çelës të kasafortës, atëherë ai/ajo do t'i kompensojë bankës shpenzimet reale dhe dëmet e shkaktuara nga hapja me forcë e kasafortës dhe/apo ndërrimi i drynit dhe çelësave.

Neni 11
Shuarja e Personit Juridik

1. Kontrata do të ndërpritet prej momentit, që banka informohet se personi juridik ka pushuar së ekzistuari.
2. Menjëherë pas njoftimit që personi juridik ka pushuar së ekzistuari, banka do të bllokojë kasafortën dhe do të japë qasje vetëm në bazë të vendimit të lëshuar nga gjykata kompetente.
3. Banka nuk ka asnjë përgjegjësi në rast se personi juridik ka pushuar së ekzistuari dhe banka nuk ka qenë e njoftuar, derisa personat e autorizuar paraprakisht i qasen dhe marrin në posedim përmbajtjen e kasafortës.
4. Sapo të njoftohet banka për shuarjen e personit juridik, banka do të njoftojë gjykatën relevante për ekzistencën e kasafortës.
5. Në rastin kur pasardhësi/pasardhësja ligjore nuk ka çelës të kasafortës, atëherë ai/ajo i kompenson bankës shpenzimet reale dhe dëmet e shkaktuara nga hapja me forcë e kasafortës dhe/apo ndërrimi i drynit dhe çelësave.

Neni 12
Hyrja në Fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 15 maj 2015.

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Bedri Peci